



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi i Komunës  
Nr. 001/011-38212  
Më: 30 mars 2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2, shkronja d), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 17 dhe 19 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e proceduarve të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe në bazë të neni 27 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, miratoi këtë:

## V E N D I M PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR.001/011-68302 TË DATËS 29.05.2025

### Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.001/011-68302 të datës 29.05.2025 të Konfirmuar nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me shkresën Nr.020-357/21 të dt:08.07.2025, për formimin e Komisionit Vlerësues prej pesë (5) anëtarësh në përbërje prej dy (2) anëtarëve të Kuvendit të Komunës, dy (2) përfaqësuesve të Ekzekutivit të Komunës dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, për vlerësimin ekonomik të ofertave pas mbylljes së ankandit, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim dhe atë ngastrën kadastrale nr.11048-17 ZK Prizren, OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Prizrenit.

### Neni 2

Neni 1 i vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet për arsye të pezullimit të vendimit për shkak të zgjedhjeve lokale që janë mbajtur vitin e kaluar dhe do të jetë si në vijim:

- 2.1 Ymran Fusha, anëtar nga Kuvendi i Komunës,
- 2.2 Astrit Temaj, anëtar nga Kuvendi i Komunës,
- 2.3 Adem Morina, anëtar nga Ekzekutivi,
- 2.4 Fatmir Memaj, anëtar nga Ekzekutivi dhe
- 2.5 Ermal Morina, anëtar nga Sektori jo qeveritar.

### Neni 3

Pjesët tjera të vendimit Nr.001/011-68302 të datës 29.05.2025 mbesin të pandryshuara.

### Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Drejtorija e Administratës  
Direktorijati za Administraciju  
Yönetim Müdürlüğü  
DALËSE-IZLAZ-ÇIKIS



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

001-011-68302/09.06.2025

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi Komunës së Prizrenit

Nr.001/011 - 68302

Më: 29 maj 2025

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 shkronja d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 17 dhe nenit 19 paragrafi 1 dhen 2, pika 2.1, të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji Nr. 06/L-092, nenit 17 dhe nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e proceduarve të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 paragrafit 1, dhe nenit 50 shkronja l) të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2025, miratoi këtë:

## V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

### Neni 1

- Themelohet Komisioni Vlerësues për vlerësimin ekonomik të ofertave pas mbylljes së ankandit, për dhënie e pronës komunale dhe atë ngastrën kadastrale nr.11048-17 ZK Prizren, OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Prizrenit, prej pesë (5) anëtarësh në përbërje prej:
  - 1.1. Egzona Hoxhaj, anëtarë nga Kuvendi i Komunës;
  - 1.2. Ilir Gashi, anëtarë nga Kuvendi i Komunës;
  - 1.3. Ramize Sinanaj, anëtarë nga ekzekutivi;
  - 1.4. Shpresa Murati, anëtarë nga Ekzekutivi dhe
  - 1.5. Latif Hoxhaj, anëtare nga Sektori jo qeveritar.
- Për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës për shpalljen e ankandit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale formohet komisioni vlerësues.

### Neni 2

Kompetencat e Komisionit do të jenë ato kompetenca të parapara konform dispozitave të neneve të përshkruara më lartë të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e proceduarve për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Komisionit dhe Njësitë përkatëse të Administratës së Komunës që i ofrojnë përkrahje komisionit vlerësues.

### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesja e Kuvendit  
Antigona Bytyqi

